

V E N D I M
Nr.199, datë 3.5.1995

PËR LEHTËSITË QË U KRIJOHEN INVALIDËVE NË NDËRTIMET PUBLIKE

Në zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Të gjitha ndërtimet e reja publike që realizohen pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” dhe të këtij vendimi, duhet të ofrojnë kushte të përshtatshme përdorimi dhe për invalidët, që mënjanojnë barrierat arkitektonike.

2. Të gjithë personat fizikë e juridikë që hartojnë projekte për ndërtime publike (spitale, shtëpi pushimi, shkolla), në mjediset e jashtme të këtyre ndërtimeve parashikojnë kushte që mbajnë parasysh interesat e invalidëve dhe të personave me aftësi të kufizuar.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ndërtimit dhe e Turizmit, Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, si dhe gjithë institucionet projektuese e zbatuese, publike e private.

4. Llojet dhe kategoritë e barrierave arkitektonike do të përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi